



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0272
Data e Vendimit: 25.04.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “NIKA PrO- Ing” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”, zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën 23/04/2025, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si e palejuar, ankesa e “NIKA PrO- Ing” SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0272, e datës 14/04/2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan”, me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”

II.I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan”, me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 14/04/2025, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, inicuar nga “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 14.04.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur në platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të rregullores 001/2022 të prokurimit publik. citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur të na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën në të kundërtën Ankesa do të refuzohet. Për të cilën OE ankues “NIKA Pro- Ing” SH.P.K.. lidhur me e-mailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa i njëjti brenda afatit ligjor nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kërkesën në fjalë.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “NIKA Pro- Ing” SH.P.K. e datës 14.04.2024 (protokoll 2025/0272), për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”., konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” , me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: